BASHKIA SHKODËR

# NDRIÇIM RRUGËSH

2020 – 2022

# Programi Buxhetor: 06440 – Ndriçim rrugësh

## PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për administrimin, instalimin, vënien në funksionim, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e ndriçimit të rrugëve

## Shpenzimet e Programit buxhetor 2017 – 2022

| Kodi | Fakt 2017 | Fakt 2018 | I Pritshmi 2019 | Plan 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 06440 | 81,754 | 99,553 | 106,464 | 97,761 | 98,380 | 109,676 |




## Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik




| | Shpenzimet korrente | Investimet |
|---|---|---|
| **Fakt 2017** | 72,539 | 9,215 |
| **Fakt 2018** | 75,122 | 24,431 |
| **I Pritshmi 2019** | 81,412 | 25,052 |
| **Plan 2020** | 79,961 | 17,800 |
| **Plan 2021** | 79,328 | 19,052 |
| **Plan 2022** | 90,624 | 19,052 |

## Treguesit Kyç të Performancës

**Qëllimi i programit**

Garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetesës së qytetarëve dhe permiresimin e ndricimit te mjediseve publike

**Objektivi 1**

Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit

| Treguesit e rezultatit | *Njësia Matëse* | | | Synimet | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *2018* | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | Trendi |
| Përmirësimi i mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit | *Lekë të ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike kundrejt totalit të shpenzimeve të bashkisë për mbulimin me ndriçim* | | **37%** | **40%** | **44%** | **44%** | ↑ |
| Sipërfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim | *Raporti sipërfaqe e mbuluar me ndriçim kundrejt totalit të sipërfaqes publike të bashkisë (në%)* | | **82%** | **83%** | **84%** | **86%** | ↑ |
| Përmirësimi i efiçiencës së buxhetit të bashkisë për shërbimin e ndriçimit publik | *Shpenzime operative dhe mirembajtje plus investime kundrejt siperfaqes totale te ndriçuar* | | **69.97** | **73.54** | **72.85** | **79.97** | ↑ |
| Përmirësimi i mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit | *Përmirësimi i kostove dhe tarifave të shërbimit nga viti në vit (në%)* | | | **3%** | **4%** | **0%** | ↑ |
| Permiresimi i shërbimit të ndriçimit në Njësitë Administrative të Bashkisë | *Zgjerimi i rrjetit me linja të reja ndriçim rrugor (ml)* | | **3,000** | **2,500** | **2,500** | **2,500** | |

## TË DHËNAT E PROGRAMIT

| | Fakt 2018 | I Pritshmi 2019 | Plan 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| **SIPËRFAQE E MBULUAR ME NDRIÇIM (*NË $M^2$*)** | | | | | |
| | | *1,306,400* | *1,329,400* | *1,350,400* | *1,371,400* |
| **TË ARDHURA NGA TARIFA E NDRIÇIMIT (*NË MIJË LEKË*)** | | | | | |
| | | *34,270* | *39,443* | *43,399* | *48,339* |
| **SHPENZIME PËR MIRËMBAJTJE DHE INVESTIME** | | | | | |
| | | *91,408* | *97,761* | *98,380* | *109,676* |

## Projektet kryesore të investimeve

| Titulli dhe përshkrim i shkurtër i projektit | Fillon | Mbaron | Viti i zbatimit | | % e realizimit nga fillimi deri në fund të vitit 2019 | Programi buxhetor |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Fonde të kontraktuara | Fonde të planifikuara | | |
| Investime ndriçimi rrugë dytësore | 2020 | 2022 | 0 | 26,504 | 0% | 06440 |
| Zëvendësimi shtyllash zinkat dhe ndriçuesve të dëmtuar dekorativ | 2020 | 2022 | 0 | 5,400 | 0% | 06440 |
| Investim Ndriçimi Rrugë kryesore | 2020 | 2022 | 0 | 24,000 | 0% | 06440 |

## Aktivitetet Kryesore

Aktivitetet kryesore të parashikuara për t'u realizuar gjatë 2020 – 2022 janë:

- Rritja e mbulimit të territorit me ndriçim publik
- Përmirësimi i efiçiencës së buxhetit të bashkisë për shërbimin e ndriçimit publik
- Përmirësimi i mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit
- Përmirësimi i shërbimit të ndriçimit në Njësitë Administrative të Bashkisë.

# FUNKSIONI 6: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

## Nënfunksioni 064: Ndriçimi i rrugëve

### Programi 06440:
### Ndriçim rrugësh

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|---|---|---|
| Sigurimi i ndriçimit të rrugëve në njësinë e vetëqeverisjes vendore. | | |
| Emri i Programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i programit |
| 06440 | Ndriçim rrugësh | Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve,mjediseve publike;<br>Zhvillimi dhe rregullimi i standarteve të ndriçimit rrugor. |

| Objektivat | Treguesit e rezultatit | Synimet | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
| O1:Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit | Rritja e mbulimit të territorit me ndriçim publik: - Sipërfaqja e shtuar e rrugëve dhe e shesheve të ndriçuara; - Sipërfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim – raporti sipërfaqe e mbuluar me ndriçim kundrejt totalit të sipërfaqes publike të bashkisë (në%) | 82% | 83% | 84% | 86% |
| | Përmirësimi i efiçiencës së buxhetit të bashkisë për shërbimin e ndriçimit publik<br>Shpenzime operative dhe mirembajtje plus investime kundrejt siperfaqes totale te ndriçuar | **69.97** | **73.54** | **72.85** | **79.97** |
| | Përmirësimi i mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit. Lekë të ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike kundrejt totalit të shpenzimeve të bashkisë për mbulimin me ndriçim (raporti në %) | | **3%** | **4%** | **0%** |
| | Permiresimi i shërbimit të ndriçimit në Njësitë Administrative të Bashkisë. | Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së ndriçimit në 7 Nj.A; | Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së ndriçimit në 7 Nj.A; | Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së ndriçimit në 7 Nj.A; | Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së ndriçimit në 7 Nj.A; |
| | | Zgjerimi i rrjetit me 3,000 ml linja të reja ndriçim rrugor; | Zgjerimi i rrjetit me 2500 ml linja të reja ndriçim rrugor; | Zgjerimi i rrjetit me 2500 ml linja të reja ndriçim rrugor; | Zgjerimi i rrjetit me 2500 ml linja të reja ndriçim rrugor; |

| Të dhënat e programit / Vitet | | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Sipërfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim në $Km^2$ | 1,306,400 | 1,329,400 | 1,350,400 | 1,371,400 |
| **2** | Shpenzime operative dhe mirëmbajtje plus investime në mijë Lekë | 91,408 | 97,761 | 98,380 | 109,676 |
| **3** | Të ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike në mijë Lekë | 34,270 | 39,443 | 43,399 | 48,339 |

| Projekte të rëndësishme | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kodi i projektit** | **Titulli dhe përshkrim i shkurtër i projektit** | **Buxheti 2020 në mijë/lekë** | **Buxheti 2021 në mijë/lekë** | **Buxheti 2022 në mijë/lekë** |
| P06440.O1.A1 | Sherbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Qytetit dhe Njësive Administrative | 97,761 | 98,380 | 109,676 |

| Informacion financiar në mijë lekë | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Vitet** | **Viti 2017** | **Viti 2018** | **Viti 2019** | **Viti 2020** | **Viti 2021** | **Viti 2022** |
| Tavani i përgjithshëm i programit | | | | 97,761 | 98,380 | 109,676 |
| Shpenzimet bruto | 81,754 | 99,553 | 106,464 | 97,761 | 98,380 | 109,676 |
| Të ardhurat e programit | 29,755 | 34,828 | 40,865 | 39,443 | 43,399 | 48,339 |
| Shpenzimet neto | 51,999 | 64,725 | 65,599 | 58,318 | 54,981 | 61,337 |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | | | | 4,554 | 4,644 | 4,738 |
| Investimet kapitale | 9,215 | 24,431 | 25,052 | 17,800 | 19,052 | 19,052 |

**Komente**

**Programi 6440: Ndricimi rrugor** ka si burim financimi te ardhurat dhe transferten e pakushtezuar. Mbulimi i shpenzimeve nga tranferta e pakushtezuar dhe te ardhurat e tjera eshte mesatarisht 61.3% . Ndersa mesatarisht 38.7% mbulohet nga tarifa e ndricimit qe perdoret vetem per funksionin e ndricimit te rrugeve. Pjesen me te madhe te shpenzimeve e zene shpenzimet korrente me rreth 77.1% ne vitin 2020, 75.9 % ne vitin 2021 dhe 78.3% ne vitin 2022. Shpenzimet kapitale zene 18.2% ne vitin 2020, 19.4% ne vitin 2021 dhe 17.4% ne vitin 2022. Ndersa shpenzimet per paga dhe sigurime shoqerore zene 4.7% ne vitin 2020, 4.7% ne vitin 2021 dhe 4.3% ne vitin 2022.

| | | |
|---|---|---|
| Nr. 1 | **P06440.O1.A1**<br>Shërbimi i Ndriçimit Publik të qytetit dhe Njësive Administrative në Bashkinë Shkodër | **Funksioni 6:** Strehimi dhe komoditeti i komunitetit<br>**N/Funksioni 064:** Ndriçimi rrugëve<br>**Llojet e programit: 06440:**Ndriçim rrugësh |

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

**i. Situata**

Shërbimi i ndriçimit publik të qytetit në Qytet, përfshin rrjetin e ndriçimit të shpërndarë si më poshtë:

- ndriçimi i rrugëve kryesore dhe dytësore
- ndriçimi i shesheve
- ndriçimi i parqeve dhe lulishteve

Sipërfaqja totale e rrugëve dhe e shesheve, arrin afërsisht në 1,600,000 $m^2$, nga të cilat 1,284,000 $m^2$ janë të ndriçuara, ose 80.2 % e sipërfaqes totale, të rrugëve dhe shesheve.
Sipërfaqet e lulishteve dhe brezit të gjelbërt zënë një hapësirë mbi 66,000 $m^2$, nga të cilat 42,000 $m^2$ janë të ndriçuara, ose 63.6 % e sipërfaqes së gjelbër është e ndriçuar.
Ndriçimi realizohet në një mesatare vjetore 10.5 orë në ditë gjatë gjithë vitit.

Asetet në dispozicion të shërbimit të ndriçimit publik për qytetin janë:

- Numri i pikave të furnizimit të energjisë (kabinave elektrike) që kanë kontratë 278 kontrata
- Numri i ndriçuesve të instaluar 5060 copë

Nëterritorin urban të qytetit ka 3 lloje shtyllash:

- **dekorative:** të cilat gjenden në zonat pedonale dhe disa nga parqet e qytetit;
- **çeliku:** pothuajse të gjitha të zinkuara, përbëjnë pjesën dominuese të shtyllave që shërbejnë për ndriçimin e qytetit;
- **betoni:** shtyllat i përkasin OSHEE, por ndriçuesit janë të Bashkisë.

Shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës. Numri i punonjësve të sektorit është 9 (nëntë).
Mirëmbajtja realizohet me të ardhurat e Bashkisë, që mbulojnë: shpenzimet për blerje materiale të ndryshme për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik, të cilat planifikohen çdo vit, në bazë të preventivave dhe miratohen në buxhetin e Bashkisë.

Në njësitë e tjera administrative situata e ndriçimit është si më poshtë:

- **Nj.A. Rrethina:**Gjatë vitit 2019 janë realizuar investimet në ndriçimin e rrugës Shtoj i Ri.Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat: Rruga Guci e Re me 10 ndriçues, Rruga Guci e Re me 16 ndriçues,fshatit Grudë me 9 ndriçues, fshati Bardhaj degëzim me 7 ndriçues Dobraç me34ndriçues, Grudë të Re me 12 ndriçues, Lagjja Vinotekë me 8 ndriçues,në fshatin Bardhaj me 15 ndriçues.
- **Nj.A. Bërdicë:** Gjatë vitit 2019 janë realizuar investime në ndriçimin e rrugës Mllojë. Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat: Rruga e Beltojës me 7 ndriçues, Trushme 25 ndriçues, në Bërdicë e Sipërme me 23 ndriçuesdhe në GjoMarkaj me 15 ndriçues.
- **Nj.A. Gur i Zi:** Gjatë vitit 2019 janë realizuar investime në ndriçimin e rrugës Shkodër– Mjedë dhe rrugës Rragam.Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat: Fshatit Ganjollë me 10 ndriçues, Vukatanë me 35 ndriçues, Juban me 12 ndriçues,Kuç me 12 ndriçues dhe Qendra e Rrencitme 22 ndriçues.
- **Nj.A. Postribë:** Gjatë vitit 2019 janë realizuar investimet në ndriçimin e rrugës së Madhe dhe rrugës Rosek.Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat: fshati Drisht me 6 ndriçues, fshati Myselim me 5 ndriçues, fshati Boks me 14 ndriçues, fshati Dragoç me 4 ndriçues,fshati Kullaj me 6 ndriçues, dhe fshati Mes me 6 ndriçues.
- **Nj.A. Dajç:**Gjatë vitit 2019 janë realizuar investimet në ndriçimin e rrugës Emigrantëve.Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat: kryqëzimi i Dajçit me 13 ndriçues, fshati Pentar me 7 ndriçues, Qendra e Dajçit me 25 ndriçues, Samrish të Ri me 5 ndriçues, Samrish i Vjetër me 18 ndriçues dhe Mushan me 20 ndriçues.
- **Nj.A. Velipojë:** Gjatë vitit 2019 janë realizuar investimet në ndriçimin e rrugës nr.7 dhe rrugës nr.13.Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat: rruga nr. 2 me 11 ndriçues, rruga nr. 3 me 8 ndriçues, plazhi Velipojë me 37 ndriçues, pedonale me 75 ndriçues, rruga hyrëse– lulishte qendër me 31 ndriçues, si dhe rruga nga Qendra deri nëHidrovori me 15 ndriçues.
- **Nj.A. Ana e Malit:** Gjatë vitit 2019 janë realizuar investimet në ndriçimin e rrugës Muriqan– Qendër dhe rrugës Goricë. Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat: rrugaOblikë (blloku i pallateve) me 6 ndriçues.

Në zbatim të buxhetit të 2019, me një fond limit prej 8,421,000 Lekë është realizuar ndriçimi i një rruge kryesore: rruga ”Harku i Bërdicës- Bahcallek”
Në zbatim të buxhetit të 2019, me një fond limit prej 7,052,000 Lekë është realizuar ndriçimi i 22 rrugëve dytësore:

- Rruga Lamijej
- Rruga Muharrem Dragovija
- Rruga Gjon Shllaku

- Rruga Foljetave
- Rruga Todi Germenji
- Bulevardi Mehmet Pashë Plaku (Blloku i parë i pallateve)
- Bulevardi Mehmet Pashë Plaku (Blloku i katërt i pallateve)
- Rruga Milosao
- Rruga Milan Shuflani
- Rruga Bisht Kazit
- Rruga Dom Nikoll Mazreku
- Rruga Emigrantëve
- Rruga Mllojë
- Rruga fshati Shtoj i Ri
- Rruga e Madhe
- Rruga Rrosek
- Rruga Nr.7 Velipojë
- Rruga Nr.13 Velipojë
- Rruga Shkodër-Mjedë
- Rruga e Rragamit
- Rruga Muriqan - Qendër
- Rruga Goricë

**Problemet e paraqituara**

- Dëmtimi i ndriçuesve, i shtyllave zinkat dhe kapakëve. Nga aksidentet rrugore dhe amortizimi i ndriçuesvejanë dëmtuar dhe kanë dalë jashtë funksioni shtylla zinkat 8 - 10 m dhe ndriçues SMART, dhe vjellja e kapakëve si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | Shtylla 8– 10 m me ndriçues SMART | copë | 35 |
| 2 | Kapakët e shtyllave | copë | 200 |

- Mosfunksionimi i linjave të ndriçimit të Unazës Lindore dhe rrugës mbikalim Ura e Bardhajve– Mes, të cilat megjithëse kanë përfunduar si investim nuk janë dorëzuar pranë Bashkisë Shkodër në administrim dhe mirëmbajtje.

**Monitorimi:**
Monitorimi i shërbimit realizohet nëpërmjet Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës. Evidentimi i defekteve dhe raportimi i tyre pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës bëhet nga njësitë administrative dhe punonjësit e ndriçimit publik sipas njësive që ata mbulojnë. Gjithashtu formë tjetër është informimi nga komuniteti nëpërmjet shkresave apo njoftimeve të ndryshme pranë zyrave të informimit për publikun në çdo Njësi Administrative.

**I. Shpenzimet për pagesat e ndriçimit rrugor për qytetin dhe njësitë administrative**

Për sektorin e ndriçimit rrugor janë aktualisht 239 kontrata aktive me rreth 4,860 ndriçues në qytet dhe 26 kontrata në njësitë e reja administrative. Në fillim të vitit në buxhet parashikohen shuma për pagesën e energjisë elektrike në bazë të fuqisë së instaluar. OSHEE faturon çdo muaj 265 kontratat e furnizimit me energji. Për çdo problem në lidhje me faturimin bëhet verifikimi në terren. Për leximin, për problemet që kontestohen, mbahet proçes-verbali përkatës dhe pastaj ndiqet në rrugë administrative dhe gjyqësore. Një herë në vit bëhet akt-rakordimi me OSHEE për të gjitha kontratat e ndriçimit rrugor. Plani i parashikuar për vitin 2019 për pagesën e energjisë së ndriçimit rrugor është 53,850,000 Lekë, ndërsa konsumi i energjisë elektrike për qytetin deri në gusht të vitit 2019 është 1,847,669KËh ose 31,181,132Lekë.

Në njësitë administrative Velipojë, Dajç, Postribë, Bërdicë, Gur iZi, Rrethina dhe Ana e Malit konsumi i energjisë elektrike, deri në gusht të vitit 2019, ka qënë203,182 KËh e barabartë me 3,493,030 lekë.

**Problemet e paraqituara**

- Faturimet e parregullta ku shpesh paraqiten probleme me mbifaturime, lexim jashtë kushteve teknike

**ii. Synimi i projektit**

Mbajtjen në efiçiencë të rrjetit të ndriçimit publik dhe menaxhimin me efektivitet si dhe pagesën për energjinë e shpenzuar nga rrjeti i ndriçimit publik.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. **Pagat, sigurimeveshoqëroredheshëndetësore**
   Shpenzimet e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e sektorit të ndriçimit publik

2. **MIRËMBAJTJE E RRJETIT ELEKTRIK.**

**Viti 2020**

Në funksion të mirëmbajtjes së rrjetit elektrik të ndriçimit publik në të gjithë Bashkinë, janë parashikuar shpenzimet në bazë të preventivave të hartuar, për ndërhyrje rehabilituese dhe riparimin e defekteve, në të gjitha rrugët, sheshet, blloqet e banimit dhe lulishtet. Parashikimi për bazën materiale për mirëmbajtje është bërë duke u bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara, ndërhyrjet rehabilituese për ndriçues të dalë jashtë përdorimi, zëvendësimi i kabllove të vjedhura në vitet e fundit, amortizimi i ndriçuesve nga orët e punës që kanë 5 vjet garanci , pjesa më e madhe e tyre e kanë kaluar këtë periudhë.

2.1 **Materiale për ndërhyrje rehabilituese**. Këtu përfshihen zëvendësimi i ndriçuesve dhe shtyllave, 8-10m me ndriçues SMART dhe shtylla 4m dekorative me ndricues LED: 35 copë. Shtylla zinkat të dëmtuar nga vjedhja e kapakëve të shtyllave: kapakët e shtyllave 200 copë.

**2.2 Materiale për mirëmbajtje e rrjetit të ndriçimit publik gjatë vitit**

Këtu përfshihen shpenzimet për materialet e domosdoshme, për riparimin e defekteve të mundshme të ndriçuesve. Në zërat kryesorë të shpenzimeve përfshihen:

- Automatë të madhësive të ndryshme 10 A deri 63 A, gjithsej 780 copë. Këto automate do i përdorim për riparimin e defekteve gjatë vitit, si dhe për dekorimin e qytetit me rastin e festave të fund vitit, ku çdo ndriçues kërkon një automat të veçantë,
- Drosel ndriçuesi 250 Ë dhe 150 Ë, gjithsej 1,710 copë
- Kabëll elektrik të madhësive 2x2.5mm$^2$, 2x4mm$^2$, 2x6mm$^2$, 3x6mm$^2$, 4x4mm$^2$, 4x6mm$^2$, 2x6mm$^2$ koksial, gjithsej 13 000 m për eliminimin e defekteve nga dëmtimet gjatë vitit
- Lëshues të kapacitetit 25A deri 40A, gjithsej 450 copë.
- Llampa SAP 150 Ë, gjithsej 1 430 copë dhe 250 Ë, gjithsej 320 copë
- Llampa floureshente 22 Ë gjithsej 405 copë,
- Rele krepuskolare modulare, 16/30 gjithsej 120 copë
- Rele krepuskolare për shtyllë, 12/25, gjithsej 120 copë
- Portollampa për llampa SAP 150 Ë, gjithsej 110 copë
- Portollampa porcelani për llampa elektronike 22 Ë, gjithsej 150 copë

- Për Vitin 2020 parashikohet një rritje e shpenzimeve për materialet e mirëmbajtjes pasi është rritur edhe sasia e shtyllave dhe ndriçuesve gjatë viteve të fundit në mënyrë të konsiderueshme. Rritja e shpenzimeve do të jetë në proporcion me sasinë e rritur gjatë këtyre viteve.

**Evidentimi i defekteve bëhet nga specialistët e punonjësit e sektorit të ndriçimit publik, inspektorët e lagjeve, nga punonjësit e njësive administrative dhe kërkesat e qytetarëve.**

3. **PAGESAT E FATURAVE TË NDRIÇIMIT PUBLIK PARASHIKOHEN:**

**Viti 2020**

3.1 Pagesa për konsumin e energjisë elektrike për 278 kontratat në qytet dhe Nj.A.

3.2 Pagesat për konsumin e energjisë elektrike për kontratat e reja që do hapen pas realizimit të investimeve të vitit 2019

3.3 Pagesat për konsumin e energjisë elektrike për kontratat nga investimet e reja gjatë vitit 2019 në njësitë e reja administrative

3.4 Pagesë tarife pranë OSHEE për hapjen e kontratave të reja në qytet dhe njësitë administrative ku janë realizuar investimet në vitin 2019 dhe ato që do të realizohen në vitin 2020

3.5 Për pagesën e ekspertit në rast të kundërshtimit të faturave të energjisë së ndriçimit rrugor në rrugë gjyqësore

Në krahasim me vitin e mëpërparshëm, do të kemi një rritje të konsumit të energjisë elektrike aq sa është edhe rritja e sasisë së ndriçuesve të rinj të vendosur për vitin 2019. Kjo rritje parashikohet të jetë në vlerat 5.5% aq sa është edhe rritja e fuqisë së instaluar të ndriçuesve të rinj në lidhje me totalin e mëparshëm.

**Monitorimi**

Funksionimi i sistemit të kontrollit të rrjetit të ndriçimit publik dhe evidentimi i defekteve nëpërmjet punonjësve të sektorit të ndriçimit publik, inspektorëve të lagjeve, njësive administrative dhe komunitetit;
Verifikimi në terren i kontratave të ndriçimit rrugor për faturat e kontestueshme;
Ndjekja e proçedurave administrative dhe gjyqësore;
Ndjekja e proçedurave për lidhjen e kontratave të reja nga specialisti përkatës;

**Shpenzime të ndryshme viti 2020**

**3 BLERJE VEGLA PËR ELEKTRIÇISTA**

Blerje vegla pune për punonjësite sektorit të ndriçimit publik

**4 FURNIZIM VENDOSJE PJESË KËMBIMI DHE MIRËMBAJTJE E MAKINERIVE**

Në funksion të mirëmbajtjes së ndriçimit dhe dekorit, janë 2 autovinçat tip

a. IVECO
b. NISSAN ,

për të cilët parashikojmë këto shpenzime për pjesë këmbimi. Në zërat kryesorë mund të përmendim: pjesë këmbimi si ndërrim filtra vaji, ajri, nafte, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, ndërrim vaj hidraulik si dhe riparime të ndryshme të paparashikueshme që mund të ketë gjatë vitit.

Në funksion të mirëmbajtjes së ndriçimit dhe dekorit janë 2 autovinçat tip

a. IVECO, në zërat kryesorë mund të përmendim: mirëmbajtje të zakoshme si ndërrim filtra vaj, ajri, nafte, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, riparim hidraulik i vinçit, riparim pompe nafte, saldimi i koshit si dhe riparime të

ndryshme të paparashikueshme që mund të ketë gjatë vitit.

b. Për autovinçin NISSAN, në zërat kryesorë mund të përmendim: mirëmbajtje të zakoshme si ndërrim filtra vaj, ajri, nafte, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, riparim hidraulik i vinçit, riparim pompe nafte, saldimi i koshit si dhe riparime të ndryshme të paparashikueshme që mund të ketë gjatë vitit.

Për secilin nga këto autovinça është hartuar preventivi përkatës i pjesëssë këmbimit e mirëmbajtjes.

**5. SHPENZIME PËR KARBURANT PËR 2 AUTOVINÇAT.**

Në bazë të normativave të llogarituara parashikohen që për secilin mjet konsumi të jetë 3960 litra në vit me një mesatare prej 330 litra në muaj për secilin mjet. Për të dy autovinçat parashikohen 7920 litra në vit.

a. IVECO 3 960 litra
b. NISSAN 3 960 litra

**6. PAGESA PËR DOKUMENTACIONIN E MJETEVE (2 AUTOVINÇAT)**

Për secilin mjet parashikojmë shumën që na nevojitet për pagesën e siguracionit, taksave dhe kolaudimit

a. Autovinçi IVECO
b. Autovinçi NISSAN

7. **INVESTIME**

**Viti 2020**

**Investime në rrugë kryesore:**

Do të realizohet studim, projektim dhe zbatim në rrugë kryesore, me gjatësi rreth 600m. Ndriçimi do të realizohet me shtylla ndriçimi LED te teknologjisë së fundit që do të kene kursim në raport me ndriçuesit e vjetër SMART SON.

**Investimet në ndriçimin e rrugëve dytësore:**

Me këtë investim do të realizohet ndriçimi në disa rrugica të qytetit dhe njësive administrative, sipas prioriteteve dhe mundësive teknike, për vendosjen e ndriçuesve. Me ketë investim do të realizohet ndriçimi publik me vendosjen e 180 ndriçuesve në rrugë të ndryshme sipas prioriteteve në qytet dhe në njësitë administrative. Ndriçimi do të realizohet, duke shfrytëzuar aty ku është e mundur, shtyllat ekzistuese dhe linjat ekzistuese, gjë që ul kostot. Disa nga rrugët që do parashikohet të investohet në ndriçim të ri janë:

Qytet:
Vazhdim i rrugës "Esat Myftija" Tepe
Blloku i pallateve tek rruga "Koplikej"
Rruga "Riza Dani"
Rruga e depos pas Hotel "Argenti"
Rruga Ludovik Saraci, 1 rrugicë
Rruga Marie Shllaku
Rruga Magjoni
Rruga Kolë Kamsi

Fshat:
Rruga Hot i Ri
Rruga Shtoj i Vjetër
Rruga Darragjat
Rruga Shirq
Rruga Oblikë- Muriqan
Rruga Obot
Rruga Rragam
Rruga Sheldi
Rruga Bërdicë e Sipërme

Gjatë vitit 2020 parashikojmë që me anë të investimeve të realizojmë zbatimin e metodave të reja të efiçiencës së energjisë si një model i mirë, inovativ dhe me reduktim të dukshëm të kostove.

Shpenzimet e planifikuara për ndërhyrjet në vitin 2020

(lekë)

| | |
|---|---|
| Paga dhe sigurime | 4,554,000 |
| Blerje materiale rehabilituese për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues | 17,000,000 |
| Pagesa e konsumit të ndriçimit | 55,000,000 |
| Te tjera | 3,407,000 |
| Investime | 17,800,000 |
| TOTAL | 97,761,000 |

Mbulimi i kostove të shërbimit të ndriçimit për vitin 2020 përllogaritet si më poshtë:

(lekë)

| Familjet | Nr.i familjeve përfituese të shërbimit | Nr. i mesatarizuar i familjeve që paguajnë tarifën e plotë të ndriçimit (jane hequr familjet me lehtësi fiskale) | Tarifa e plotë e ndriçimit | Nr. i mesatarizuar i familjeve që paguajnë tarifën e pjesshme të ndriçimit (jane hequr familjet me lehtësi fiskale) | Tarifa e pjesshme e ndriçimit | Të ardhurat nga tarifat e ndriçimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Rrethinat | 4,901 | 3,015 | 480 | 695 | 240 | **1,614,000** |
| Postribë | 1,609 | 391 | 480 | 18 | 240 | **192,000** |
| Guri i Zi | 1,907 | 209 | 480 | 32 | 240 | **108,000** |
| Ana Malit | 1,017 | 192 | 480 | 16 | 240 | **96,000** |
| Bërdicë | 1,425 | 713 | 480 | 74 | 240 | **360,000** |
| Dajç | 1,152 | 306 | 480 | 13 | 240 | **150,000** |
| Velipojë | 1,270 | 805 | 480 | 40 | 240 | **396,000** |
| Shkodër | 21,253 | 15,470 | 1,200 | 3,998 | 600 | **20,963,000** |
| | | | | | **TOTAL** | **23,879,000** |

| | |
|---|---|
| Të ardhurat nga biznesi | **15,439,000** |
| Të ardhurat nga institucionet | **125,000** |
| **TOTALI I TË ARDHURAVE TË PLANIFIKUARA** | **39,443,000** |

**Burimet e financimit për shërbimin ndriçimit rrugor**




Planifikimi për Vitin 2020 dhe Vitin 2021

**Janë parashikuar shpenzimet për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik dhe materiale për ndërhyrje rehabilituese. Do të realizohet blerje e materialeve të ndryshme të domosdoshme, për mirëmbajtjene rrjetit elektrik si: automatë, drosela, kabëll elektrik, lëshues, llampa, rele krepuskolare, portollampa, etj.**

Janë parashikuar shpenzimet, për pagesën e energjisë elektrike, për hapjen e kontratave të reja, për pagesën e ekspertit, në rast të kundërshtimit të faturave të energjisë së ndriçimit rrugor në rrugë gjyqësore

Janë parashikuar shpenzimet për:

- Blerje vegla për elektriçista (materiale konsumi)
- Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për autovinçat
- Blerje karburant
- Pagesa për dokumentacion e autovinçat, etj.

Do të bëhet rehabilitimi i disa rrugëve të reja kryesore të qytetit me ndriçues LED. Ndërtim i ndriçimit publik në 3,700 m rrugë dytësore po me ndriçim LED me reduktim kostoje.

b) Rezultatet që prisni

**Viti 2020**
Mirëmbajtja e gjithë rrjetit të ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë:

- 1,329,000 $m^2$ sipërfaqe e ndriçuar e mirëmbajtur;
- 42,000 $m^2$ sipërfaqe e gjelbëruar e ndriçuar e mirëmbajtur
- Mirëmbajtje e 5,060 ndriçuesve të zakonshëm;
- Mirëmbajtje e 148 ndriçuesve dekorativ;

Realizimi i lidhjes të kontratave të reja në qytet dhe njësitë administrative për 23 rrugë të reja të ndriçuara gjatë vitit 2019;
Realizimi i pagesës për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike (55,000,000 lekë) për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative;
Realizimi i ndriçimit publik në 1,300 m rrugë kryesore;
Realizimi i ndriçimit publik në 5,600 m rrugë dytësore të reja në qytet dhe në njësi administrative.
Rritje e sipërfaqes së ndriçuar nga 1,309,000 $m^2$në 1,329,000 $m^2$, nga 82% sipërfaqe rrugësh e ndriçuar në rritjen në 83% sipërfaqe e ndriçuar;

**Viti 2021**
Mirëmbajtja e gjithë rrjetittë ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë
Zëvendësimi ndriçuesve dekorativ dhe shtyllave metalike
Zëvendësimi i ndriçuesve të dalë jashtë përdorimit
Realizimi i lidhjes së kontratave të reja në qytet dhe njësitë administrative
Realizimi i pagesës për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative
Realizimi i ndriçimit publik në 5,000 m rrugë dytësore;
Rritja e efiçencës nëpërmjet vendosjes së ndriçuesve LED;

**Viti 2022**
Mirëmbajtja e gjithë rrjetittë ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë
Zëvendësimi ndriçuesve dekorativ dhe shtyllave metalike
Zëvendësimi i ndriçuesve të dalë jashtë përdorimit
Realizimi i lidhjes së kontratave të reja në qytet dhe njësitë administrative
Realizimi i pagesës për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative
Realizimi i ndriçimit publik në 4,000 m rrugë dytësore
Rritja e efiçencës nëpërmjet vendosjes së ndriçuesve LED

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| Punonjësit e sektorit të ndriçimit<br>Banorët e qytetit dhe njësive të reja administrative;<br>Qytetarët;<br>Bizneset;<br>Institucionet e tjera si OSHEE, etj. | Bashkia Shkodër |

e) Shpenzimet e llogaritura

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2020 | | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Paga | Sig uri me | Operati ve | T | Kapitale |
| A.1.1 | **Pagat dhe sigurimet** | | **4,554** | 3,929 | 625 | | | |
| A.1.2 | **Blerje materiale rehabilituese për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues** | | **17,000** | | | 17,000 | | |
| A.1.3 | **Pagesa e konsumit të ndriçimit** | | | | | | | |
| | A.1.3/1 | Pagesa e konsumit të ndriçimit publik (ekzistues+zgjerim) sipas faturimit OSHEE Bashkia Shkodër (qyteti dhe njësitë administrative) | **55,000** | | | 55,000 | | |
| | A.1.3/2 | Kosto për lidhje kontrate me OSHEE qytet e njësitë e tjera | **500** | | | 500 | | |
| | A.1.3/3 | Shërbimeekspertipërproçesegjyqësore | **50** | | | 50 | | |
| A.1.4 | **Blerje vegla pune dhedokumentacion teknik** | | | | | | | |
| | A.1.4.1 | Blerje vegla pune për elektriçista | **300** | | | 300 | | |
| | A.1.4.2 | Paisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve | **80** | | | 80 | | |
| A.1.5 | **Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e makineriv** | | **1,000** | | | 1,000 | | |
| A.1.6 | **Shpenzime për karburant për autovinçat** | | **1,350** | | | 1,350 | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1.7 | **Pagesa për dokumentacionin** | | | | | | | |
| | A.1.7/1 | Pagesa siguracion për autovinçin IVECO | **37** | | | 37 | | |
| | A.1.7/2 | Pagesa siguracion për autovinçin NISSAN | **24** | | | 24 | | |
| | A.1.7/3 | Pagesa për taksa e kolaudim për autovinçin IVECO | **24** | | | 24 | | |
| | A.1.7/4 | Pagesa për taksa e kolaudim për autovinçin NISSAN | **42** | | | 42 | | |
| A.1.8 | **Investime** | | | | | | | |
| | A.1.8/1 | Investime ndriçimi rrugë dytësore | **8,000** | | | | | 8,000 |
| | A.1.8/2 | Zëvendësimi shtyllash zinkat dhe ndriçuesve të dëmtuar dekorativ | **1,800** | | | | | 1,800 |
| | A.1.8/3 | Investim Ndriçimi Rrugë kryesore | **8,000** | | | | | 8,000 |
| | | **Shuma 2020** | **97,761** | **3,929** | **625** | **75,407** | | **17,800** |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2021** | | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Paga | Sigu rime | Opera tive | T | Kapitale |
| A.1.1 | **Pagat dhe sigurimet** | | **4,644** | 4,007 | 637 | | | |
| A.1.2 | **Blerje materiale rehabilituese për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues** | | **16,700** | | | 16,700 | | |
| A.1.3 | **Pagesa e konsumit të ndriçimit** | | | | | | | |
| | A.1.3/1 | Pagesa e konsumit të ndriçimit publik (ekzistues+zgjerim) sipas faturimit OSHEE Bashkia Shkodër (qyteti dhe njësitë administrative) | **55,000** | | | 55,000 | | |
| | A.1.3/2 | Kosto për lidhje kontrate me OSHEE qytet e njësitë e tjera | **500** | | | 500 | | |
| | A.1.3/3 | Shërbimeekspertipërproçesegjyqësore | **50** | | | 50 | | |
| A.1.4 | **Blerje vegla pune dhedokumentacion teknik** | | | | | | | |
| | A.1.4.1 | Blerje vegla pune për elektriçista | **300** | | | 300 | | |
| | A.1.4.2 | Paisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve | **80** | | | 80 | | |
| A.1.5 | **Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e makineriv** | | **577** | | | 577 | | |
| A.1.6 | **Shpenzime për karburant për autovinçat** | | **1,350** | | | 1,350 | | |
| A.1.7 | **Pagesa për dokumentacionin** | | | | | | | |
| | A.1.7/1 | Pagesa siguracion për autovinçin IVECO | **37** | | | 37 | | |
| | A.1.7/2 | Pagesa siguracion për autovinçin NISSAN | **24** | | | 24 | | |
| | A.1.7/3 | Pagesa për taksa e kolaudim për autovinçin IVECO | **24** | | | 24 | | |
| | A.1.7/4 | Pagesa për taksa e kolaudim për autovinçin NISSAN | **42** | | | 42 | | |
| A.1.8 | **Investime** | | | | | | | |
| | A.1.8/1 | Investime ndriçimi rrugë dytësore | **9,252** | | | | | 9,252 |
| | A.1.8/2 | Zëvendësimi shtyllash zinkat dhe ndriçuesve të dëmtuar dekorativ | **1,800** | | | | | 1,800 |
| | A.1.8/3 | Investim Ndriçimi Rrugë kryesore | **8,000** | | | | | 8,000 |
| | | **Shuma 2021** | **98,380** | **4,007** | **637** | **74,684** | | **19,052** |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2022** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigu rime | Opera tive | | Kapitale |
| A.1.1 | **Pagat dhe sigurimet** | **4,738** | 4,088 | 650 | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1.2 | **Blerje materiale rehabilituese për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues** | | **19,800** | | | 19,800 | | |
| A.1.3 | **Pagesa e konsumit të ndriçimit** | | | | | | | |
| | A.1.3/1 | Pagesa e konsumit të ndriçimit publik (ekzistues+zgjerim) sipas faturimit OSHEE Bashkia Shkodër (qyteti dhe njësitë administrative) | **59,600** | | | 59,600 | | |
| | A.1.3/2 | Kosto për lidhje kontrate me OSHEE qytet e njësitë e tjera | **1,500** | | | 1,500 | | |
| | A.1.3/3 | Shërbimeekspertipërproçesegjyqësore | **100** | | | 100 | | |
| A.1.4 | **Blerje vegla pune dhedokumentacion teknik** | | | | | | | |
| | A.1.4.1 | Blerje vegla pune për elektriçista | **800** | | | 800 | | |
| | A.1.4.2 | Paisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve | **159** | | | 159 | | |
| A.1.5 | **Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e makineriv** | | **1,600** | | | 1,600 | | |
| A.1.6 | **Shpenzime për karburant për autovinçat** | | **2,200** | | | 2,200 | | |
| A.1.7 | **Pagesa për dokumentacionin** | | | | | | | |
| | A.1.7/1 | Pagesa siguracion për autovinçin IVECO | **37** | | | 37 | | |
| | A.1.7/2 | Pagesa siguracion për autovinçin NISSAN | **24** | | | 24 | | |
| | A.1.7/3 | Pagesa për taksa e kolaudim për autovinçin IVECO | **24** | | | 24 | | |
| | A.1.7/4 | Pagesa për taksa e kolaudim për autovinçin NISSAN | **42** | | | 42 | | |
| A.1.8 | **Investime** | | | | | | | |
| | A.1.8/1 | Investime ndriçimi rrugë dytësore | **9,252** | | | | | 9,252 |
| | A.1.8/2 | Zëvendësimi shtyllash zinkat dhe ndriçuesve të dëmtuar dekorativ | **1,800** | | | | | 1,800 |
| | A.1.8/3 | Investim Ndriçimi Rrugë kryesore | **8,000** | | | | | 8,000 |
| | | **Shuma 2022** | **109,676** | **4,088** | **650** | **85,886** | | **19,052** |

**f) Periudha e zbatimit**
Gjatë viteve 2020– 2022

**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**
Drejtoria Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës
**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër